

NJOFTIM

Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, për vitin akademik 2020-2021, ofron programet e studimit të ciklit të dytë, me kuotat përkatëse, si më poshtë:

I. MASTER SHKENCOR

A. Në Inxhinieri Gjeologjike, me profile:	KUOTA
Vendburimet e Mineraleve të Dobishme-Petrologji	15
B. Në Inxhinierinë e Burimeve Minerare, me profile:	
Inxhinieri Miniere dhe Markshajderi	10
Inxhinieri GIS dhe Modelim Minerar	15
C. Në Inxhinierinë e Naftës dhe Gazit	17
D. Në Inxhinieri Gjeomjedisi	15
E. Në Inxhinieri Industriale	20

II. MASTER PROFESIONAL

A. Në Inxhinieri Gjeologjike, me profile:	
Gjeoinformatikë	15
Gjeologji inxhinierike dhe Hidrogjeologji	15
Gjeologji e Vendburimeve Hidrokarbure	15
Vendburimet e Mineraleve të Dobishme-Petrologji	15
B. Në Inxhinieria e Burimeve Minerare, me profile:	
Gjeomatikë	18
C. Në Inxhinierinë e Naftës dhe Gazit	20
D. Në Inxhinieri Gjeomjedisi	18

Kanë të drejtë të aplikojnë për MASTER kandidatët që (Udhëzimi i MASR nr. 17, datë 30.07.2019, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 10, datë 15.05.2019, për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë", kreu IV/4, pika 8):

1. Kanë përfunduar me sukses studimet në një program të ciklit të parë, i cili rezulton i licencuar në momentin e regjistrimit të studentit dhe akredituar në momentin e diplomimit të studentit, ose:
2. Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të akredituar, (Në rast pranimit kandidati është i detyruar të kryejë njësimin e diplomës pranë QSHA-së).



I. KRITERET PËR MASTER SHKENCOR:

1. Nota mesatare e ciklit të parë të studimeve preferohet më e madhe ose e barabartë me 7;
2. Dëshmia e mbrojtjes së gjuhës së huaj (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht), në nivelin B1. Dorëzimi i dëshmisë duhet të bëhet deri para sesionit të mbrojtjes së diplomave.
3. Numri i kuotave të ofruara dhe plotësimi i tyre sipas parimit "meritë-preferencë";
4. Plotësimi i numrit minimal, 10 (dhjetë) studentë, si kusht për hapjen e programit përkatës të studimit;
5. Vazhdimësia e të njëjtit program studimi të ciklit të parë edhe në ciklin e dytë të studimeve, përbën përparësi.
6. Preferenca e studentit (1, 2, 3), për diplomën e zgjedhur dhe momenti i aplikimit nuk përbëjnë përparësi.
7. Diploma "*Master i Shkencave*" nuk mund të hapet nëse, së paku, 6 (gjashtë) studentë nuk vijnë nga i njëjti program studimi i ciklit të parë.

II. KRITERET PËR MASTER PROFESIONAL:

1. Numri i kuotave të ofruara dhe plotësimi i tyre, sipas parimit "meritë-preferencë";
2. Plotësimi i numrit minimal, 10 (dhjetë) studentë, si kusht për hapjen e programit përkatës të studimit;
3. Vazhdimësia e të njëjtit program studimi të ciklit të parë edhe në ciklin e dytë të studimeve, përbën përparësi.
4. Preferenca e studentit (1, 2, 3), për diplomën e zgjedhur dhe momenti i aplikimit nuk përbëjnë përparësi.
5. Diploma "*Master Profesional*" nuk mund të hapet nëse, së paku, 6 (gjashtë) studentë nuk vijnë nga i njëjti program studimi i ciklit të parë.

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR REGJISTRIM:

1. Kandidati paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij dhe dorëzon në Sekretarinë e Fakultetit, dokumentacionin e mëposhtëm:
2. Diplomë ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në vend. Diplomën e ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës;
3. Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me çertifikatën e notave ose fotokopje të tyre të njësuar me origjinalin, e konfirmuar nga institucioni përkatës arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar



(DRAP/ZVAP). Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr.876, datë 3.11.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 78, datë 8.2.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimin në shkollat e larta publike", i ndryshuar, paraqesin Dëftesën e Pjekurisë (origjinal ose fotokopje të saj, të njësuar me origjinalin), të konfirmuar nga institucioni përkatës arsimor vendor;

4. Formularin e aplikimit dhe deklaratën përkatëse (gjenden në Sekretarinë e Fakultetit);
5. Fotokopjen e dokumentit të identifikimit (ID ose pasaportë).
6. Dy fotografi personale.
7. Dëshmia e gjuhës së huaj, vetëm për aplikantët për Master Shkencor.

KALENDARI I APLIKIMIT DHE REGJISTRIMIT DO TË JETË SI MË POSHTË

(Udhëzimi nr. 17, datë 30.07.2019, shtojca 10, Urdhëri i përbashkët nr. 2, datë 02.07.2020 i ndryshuar me Urdhërat e përbashkët Nr. 03 dt. 06.08.2020 dhe nr. 04 dt. 30.09.2020):

1. Aplikimi pranë Sekretarisë Mësimore të Fakultetit.
22. 10 2020 deri në 04.11. 2020
2. Shpallja e listave të aplikantëve
06.11. 2020
3. Shqyrtimi i aplikimeve dhe renditja e tyre nga Komisionet ad hoc, të ngritur pranë Departamenteve përkatëse.
10. 11. 2020
4. Shpallja e listës së renditur të kandidatëve fitues.
11. 11. 2020
5. Ankimimi: Tre ditë kalenderike pune, pas shpalljes.
11.11. 2020 deri në 13.11. 2020
6. Shpallja e listës përfundimtare të renditur të kandidatëve fitues pas procesit të ankimimit.
13. 11. 2020
7. Regjistrimi i kandidatëve fitues, pranë Sekretarisë Mësimore të Fakultetit.
16. 11. 2020 deri në 20. 11. 2020
8. Regjistrimi për kuotat e paplotësuara
25. 11. 2020
9. Dërgimi në QSHA i listës së studentëve të regjistruar (format elektronik dhe letër), për pajisje me numër matrikullimi.
Deri më 15.12.2020